



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:225984

Datë: 19.12.2022

Numri i dokumentit: 03768224

**C.nr.1000/2021**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Afrim Gashi**, në çështjen juridike të paditësve H. K. nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, A. S. nga Rahoveci, M. D. - Xh., nga Prizreni, H. R. - R., nga Rahoveci dhe D. M. nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati A. M. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B. O., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës - licencim, vlera e kontestit 14.279.78 Euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, më 19.12.2022, morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** padia dhe kërkesëpafia e paditësve H. K., A. S., M. D. - Xh., H. R. - R. dhe D. M. dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit nga marrëdhënia e punës -kompensim, paditësve tua paguaj si vijon:

- Paditëses H. K., në emër të kompensimit për licencim, me fakultet katërvjeçar, për 27%, të pagës mujore 421 Euro, përkatësisht  $421 \times 27\% = 113.67$  Euro, e duke zbritur 58.32 Euro që iu janë paguar me kontratë-listën e pagave, pra për çdo muaj nga 55.35 €, ( $113.67 - 58.32 = 55.35 \times 46$  muaj, = 2.546.10), tija paguaj shumën e përgjithshme prej **2.546.10 Euro**.
- Paditëses A. S., në emër të kompensimit për licencim, me fakultet katër vjeçar, për 27%, të pagës mujore 421 Euro, përkatësisht  $421 \times 27\% = 113.67$  Euro, e duke zbritur 58.32 Euro që iu janë paguar me kontratë-listën e pagave, pra për çdo muaj nga 55.35 € ( $113.67 - 58.32 = 55.35 \times 46$  muaj, = 2.546.10), tija paguaj shumën e përgjithshme prej **2.546.10 Euro**.
- Paditëses M. D. - Xh., në emër të kompensimit për licencim, me master për 35%, të pagës mujore 421 Euro, përkatësisht  $421 \times 35\% = 147.35$  Euro, e duke zbritur 58.32 Euro që iu janë paguar me kontratë-listën e pagave, pra për çdo muaj nga 89.03 €, ( $147.35 - 58.32 = 89.03 \times 46 = 4.095.38$ ), tija paguaj shumën e përgjithshme prej **4.095.38 Euro**.
- Paditëses H. R. - R., në emër të kompensimit për licencim, me fakultet katër vjeçar, për 27%, të pagës mujore 421 Euro, përkatësisht  $421 \times 27\% = 113.67$  Euro, e duke zbritur

58.32 Euro që iu janë paguar me kontratë-listën e pagave, pra për çdo muaj nga 55.35 € (113.67-58.32=55.35 x 46 muaj,= 2.546.10), tija paguaj shumën e përgjithshme prej **2.546.10 Euro**.

- Padi tëses D. M., në emër të kompensimit për licencim, për 27%, të pagës mujore 421 Euro, përkatësisht  $421 \times 27\% = 113.67$  Euro, e duke zbritur 58.32 Euro që iu janë paguar me kontratë-listën e pagave, pra për çdo muaj nga 55.35 € (113.67-58.32=55.35 x 46 muaj,= 2.546.10), tija paguaj shumën e përgjithshme prej **2.546.10 Euro**, përkatësisht për të gjithë padi tësën, shumën prej 14.279.78 Euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (08.07.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

**DETYROHET** e paditura që në po të njëjtin afat, padi tësve t'ua paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 645 Euro me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Padi tësën H. K. , A. S., M. D. - Xh., H. R. - R. dhe D. M. nga Rahoveci , të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati A. M. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës - licencim.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i padi tësve avokati A. M., si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B. O. jurist i diplomuar, është bërë leximi i padisë dhe përgjigjes në padi.

Përfaqësuesi i autorizuar i padi tësve avokati A. M. ka deklaruar se ngeli në tërësi pranë padisë së ushtruar kërkesë-padisë rithesoj se këtu padi tësja H. K. me kontratë të punës nr. 59/18, prej datës 01.09.2015, padi tësja e dyte A. S. me kontratë të punës nr. 106 prej datës 01.09.2016, padi tësja e trete M. D.- Xh. me kontratë pune prej datës 04.10.2018, D. M. me kontratë pune nr. 111/18 prej datës 01.11.2016, dhe H. R. – R. janë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar tek e paditura përkatësisht pranë SHFMU “Dëshmorët e Zatriqi” në fshatin Zatriq. Këtu padi tësve pos të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, sipas Vendimit të ish Kryeministrit të Kosovës nr. 01/13 prej datës 29.08.2008 i cili vendim është ende në fuqi si dhe dispozitave të nenit 7 të kontratës kolektive të arsimit parauniversitar të viti 2017, u ka takuar edhe kompensimi në emër të kualifikimit nga 27% me fakultet 4 vjeçar nga paga bazë nga 421 euro, përkatësisht për çdo muaj nga 113,67 euro e duke zbritur për secilin padi tës nga 58,32 euro që iu janë paguar me kontratë përkatësisht në listën e pagave kështu që e paditura u ka mbetur pa kompensuar të gjithë padi tësve për çdo muaj nga 55,45 euro duke filluar prej datës 18.04.2017 kur ka hyre në fuqi Kontrata Kolektive e përfundimisht me 31.12.2020. Përndryshe padi tëset kanë qenë të vullnetit të mirë që çështja të zgjidhet në procedurë administrative me kërkesë të veçantë me nr. prot.3639 prej datës 30.09.2021 iu janë drejtuar të paditurës mirëpo as sot e kësaj dite nuk kanë marrë kurrfarë përgjigje. I propozoj gjykatës që të zbatoj procedurën e provave të administroj të gjitha provat e propozuara dhe në fund ta miratoj kërkesë-padinë e padi tësve në tërësi si me bazë.

Kërkojë shpenzimet procedurale sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve avokati A. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe më tej ngeli ne tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, theksoj se gjykata duke proceduar si prova të veçanta kontratat e punës për secilën paditëse ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditëset janë ne marrëdhënie pune pranë te paditurës përkatësisht pranë SHFMU “Dëshmorët e Zatriqi ne Zatriq se të gjithë paditëse kanë të kryer fakultetin 4 vjeçar e duke proceduar si prova të veçanta listat e pagave për secilën paditëse ka vërtetuar faktin se këtu paditëseve e sipas kontratës përkatësisht nga lista e pagave, secilën paditëse iu janë paguar nga 58,32 euro ndërsa e paditura nuk e ka kompensuar pjesën tjetër për secilën paditëse nga 55,45 euro. Gjatë procedurës, gjykata si prova te veçanta i ka proceduar edhe licencat e punës për secilën paditëse veç e veç dhe nga këto prova po ashtu ka vërtetuar faktin relevant se të gjithë paditëset nga ana MASHT-it janë pajisur me licencat e punës. Duke marrë për bazë gjendjen faktike të vërtetuar ne mënyre të plotë me prova formalo- materiale, i propozoj në fund gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta miratoj ne tërësi si me bazë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës avokati B. O. ka deklaruar se në parim në tërësi e kontestojmë kërkesëpadinë dhe e kundërshtojmë precizimin/zgjerimin e padisë në kuptimin objektiv si të pabazuar dhe të pathemeltë ndaj të paditurës komuna e Rahovecit, me arsyetimin se është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për shkak se paditësit kanë kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së KKAK-së të datës 18.04.2017, e cila kontratë ka qenë në fuqi deri më 17.04.2020. Vlefshmërinë e Kontratës Kolektive e ka përcaktuar Neni 90 par. 4 të Ligjit të Punës, me të cilin është përcaktuar se: “Kontrata Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar, jo më shumë se tre (3) vjet”, ashtu që sipas nenit 4 par.1 të po të njëjtit ligj parashihet se “Dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji”, si dhe të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga MASHT dhe SBASHK ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruese e kësaj kontrate si nivel lokal kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i Ligjit të Punës me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. Mbrojtja e të paditurës mbetet në qëndrimin si në përgjigje në padi, ngase kontrata kolektive është nënshkruar në mes të MASHT dhe SBASHK dhe ashtu siç konstaton edhe Gjykata Kushtetuese në rastin numër KO139/18 se kjo kontratë reflekton vullnetin reciprok në mes të dy palëve nënshkruese. Konsiderojmë se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë administrative për të realizuar interesin e tyre juridik në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të ligjit numër 06/L-114 për zyrtarët publik.

Sa i përket buxhetimit të mjeteve lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e paditura në përgjigje në padi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e alokimit të buxhetit për nivelin lokal siç është e paditura këtu, theksojmë se në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, 2020 dhe 2021 në asnjë nga këto qarkore të cilat konsiderohen dokumente bazë për krijimin e buxhetit vjetor, nuk është paraparë respektivisht nuk është alokuar asnjë mjet financiar për kompensimin e ushqimit apo të udhëtimit. Për vitin 2019 komunës së Rahovecit i janë alokuar mjetet në shumën prej 22.967,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse, kjo në bazë të kalkulatorit sipas pikës 2.2 të kësaj qarkore. Në vitin 2020 komunës së Rahovecit i janë alokuar 46.643,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit, ndërsa për vitin 2021 në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit janë ndarë gjithsej 42.150,00 Euro dhe për herë të parë janë ndarë 27.169,00 Euro në emër të pagave jubilarë sipas kontratës kolektive andaj përtej kësaj që është paraparë në Ligjin për Buxhetin e RKS-së dhe ndarjes buxhetore, e paditura nuk ka kompetencë ligjore për të kryer pagesat tjera në emër të kompensimeve sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar. Në aspekt procedural gjykata nuk ka vepruar në përputhje me nenin 67 dhe 68 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i propozojmë gjykatës që kësaj lënde të ia bashkojë edhe lëndë të tjera me paditës me bazë të njëjtë të padisë

në emër të parimit të ekonomizimit të procedurës. Gjithashtu deklaroj se KKAK në nenin 7 nuk ka përcaktuar se duhet të kompensohet mësimdhënësi me përqindjen sipas kërkesëpadisë, po ashtu nëse ky kompensim duhet të bëhet nga punëdhënësi drejtpërdrejtë, andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv në kuptim të dispozitës së nenit 7 të KKAK për të qenë palë në procedurë. Të gjithë paditësit janë kompensuar në emër të kualifikimit dhe fakultetit sipas listës së pagave, ku për secilin kemi paraqitur të dhëna rreth kompensimit sipas kualifikimit në përgjigje në padi bazuar në listën e pagave. Andaj, të gjitha këto pagesat e kryera duhet të llogariten në emër të kompensimit sipas kualifikimit për secilin paditës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës avokati B. O. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi në të gjitha deklaratimet si më lartë. Në bazë të bazës juridike në të cilën thirret padia dhe kërkesëpadija e paditësve e që është Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017, në aspekt të vlefshmërisë të KKAK-së, nuk ka bazë ligjore, për arsye se KKAK ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 – 17.04.2020, kjo edhe në kuptim të nenit 90 par.4 të Ligji të Punës, me të cilin është përcaktuar se kontrata kolektive mund të lidhet në një afat të caktuar kohor, por jo më gjatë se 3 vite. Në bazë të nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, është përcaktuar se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*. Në kuptim të kësaj dispozite të Ligjit të Punës, Kontrata Kolektive e Arsimit ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 deri më 17.04.2020. Nga kjo rezulton se përtej datës 17.04.2020, kërkesëpadija e paditësve është e pabazë, sepse në këtë periudhë nuk ka pasur Kontratë Kolektive të Arsimit. Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur më 22.01.2021 nuk ka efekt retroaktiv, për çka rezulton se e paditura nuk ka detyrim që paditësve t’u paguaj shumat në emër të kualifikimit, respektivisht në emër të kompensimeve tjera sipas dispozitave të kontratës që kanë implikime financiare, për periudhën kohore prej datës 18.04.2020. Ky qëndrim i të paditurës është në harmoni me Aktgjykimin C.nr. 474/2019, i datës 03.02.2022, i Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec. Gjithashtu, afati për pagesat sipas dispozitave të nenit 35 të KKAK-së, është parashkruar në tërësi, në përputhje me Procesverbalin Nr.797/2021, i dt. 21.10.2021, lidhur me mbajtjen e kolegjiut të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për unifikimin e praktikës gjyqësore, në pjesën II, sa i përket çështjes se kur duhet të llogaritet afati i parashkrimit, është nxjerrë konkluzioni se afati i parashkrimit duhet të llogaritet nga momenti kur ka hyrë në fuqi Kontrata. Paditësit kanë parashtruar padi në gjykatë më 06.10.2021, në këtë mënyrë konsiderojmë se kërkesëpadija është parashkruar në tërësi, ngase nga hyrja në fuqi e KKAK-së më 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në gjykatë më 06.10.2021, kanë kaluar më shumë se tri vite. Meqenëse padia është mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017, e cila ka qenë në fuqi nga 18.04.2017 deri më 17.04.2020, ndërsa aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë gjithashtu e ka arsyetuar duke u mbështetur në këtë të drejtë materiale, në anën tjetër paditësit kanë parashtruar padi në gjykatë më 06.10.2021 (shih vulën e pranimit të gjykatës), në këtë mënyrë konsiderojmë se kërkesëpadija e paditësve është e parashkruar në tërësi, ngase nga hyrja në fuqi e KKAK-së më 18.04.2017 e deri në parashtrimin e padisë në gjykatë më 06.10.2021, kanë kaluar më shumë se tri vite. Një konstatim të këtillë e ka dhënë edhe Gjykata e Apelit me Aktgjykim Ac.nr.1356/2021 i dt. 17.03.2022 si dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr. 2871/2021, i datës 19.04.2022, me të cilin gjykata sqaron afatin për parashkrim në kuptim të nenit 90.4 dhe 87 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Gjithashtu, me disa aktgjykime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, si shembull aktgjykimi Rev.nr.580/2021 dt. 11.01.2022, është krijuar praktikë gjyqësore e mjaftueshme sa i përket afatit për parashkrim të padisë bazuar në Kontratën Kolektive si dhe çështjeve tjera lidhur me kontratat kolektive. Kujtojmë se aktgjykimi i atakuar është mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017. Mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pabazë. Padyshim se mund të konkludohet se të paditurës gjithashtu i mungon legjitimiteti pasiv për shkak se nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në nivel të komunës siç parasheh Ligji i Punës për nënshkrimin e kontratave në tri nivele, në nivel vendi,

në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes. Për të zbatuar dispozitat që kanë implikime financiare të kontratës kolektive, në të njëjtën janë paraparë dispozitat e nenit 46 të Kontratës Kolektive për mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare dhe alokimin e të njëjtave të nivelit lokal në vijë të veçantë buxhetore për të kryer obligimet sipas nenit 35 paragrafi 5,7 dhe 9 të Kontratës Kolektive. Këtyre dispozitave nuk i janë përmbajtur nënshkruesit e Kontratës Kolektive që janë MASHT-i dhe SBASHK-u. Propozimi i palës së paditur për bashkimin e lëndëve me bazë të njëjtë juridike e që është Kontrata Kolektive e Arsimit ka të bëjë me të gjitha paditë që gjykata i ka pranuar nga paditësit të një shkolle të caktuar. Andaj aprovimi i kërkesëpadisë së paditësve cenon rëndë sigurinë juridike të Komunës së Rahovecit si palë e vetme e paditur. Komuna e Rahovecit në parim nuk i kundërshton dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, po mos zbatimi i dispozitës të nenit 46 nga palët nënshkruese të kontratës për sa i përket planifikimit të sigurimit dhe alokimit të mjeteve të nevojshme për zbatimin e dispozitave që kanë implikime financiare është pamundësuar zbatimi në tërësi i kësaj kontrate. Në fund, i kundërshtojmë në tërësi shpenzimet procedurale të kërkuara nga pala paditëse si më lartë.

Mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pabazë si dhe të obligojë paditësit që në emër të shpenzimeve procedurale, të paditurës t'i paguajnë shumën sipas vlerës së kontestit në përputhje me tarifën, si dhe shpenzimet tjera që mund të krijohen, varësisht nga zhvillimi i procedurës civile, të cilat mjete të derdhen në xhirollogarinë e të paditurës Komuna e Rahovecit 100 6502 5000 0012, pranë BQK-së, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar këto prova:

- Për paditësen H. G.-K., bëhet leximi i kontratës së punës me nr.prot.59/18 të datës 01.09.2018, leximi i vërtetimit të punës me nr.prot.227 të datës 19.07.2021, leximi i diplomës së fakultetit me nr.428 të datës 11.10.1997, leximi i listës së pagave të datës 30.04.2021, leximi i licencës së punës me nr.prot.08/2012 të datës 23.03.2011, leximi i kërkesës me nr.prot.4630 të datës 30.09.2021,

- Për paditësen A. S., bëhet leximi i kontratës së punës me nr.prot.106 të datës 01.09.2016, leximi i vërtetimit të punës me nr.prot.228 të datës 19.07.2021, leximi i diplomës së fakultetit me nr.74 të datës 15.11.2016, leximi i listës së pagave të datës 30.04.2021, leximi i licencës së punës me nr.prot. 1027409, të datës 27.09.2019, leximi i kërkesës me nr.prot.4630 të datës 30.09.2021,

- Për paditësen M. D. - Xh., bëhet leximi i kontratës së punës me nr.prot. 107 të datës 10.05.2016, leximi i vërtetimit të punës me nr.prot.226 të datës 19.07.2021, leximi i diplomës së fakultetit me nr.555 të datës 23.08.2019, leximi i listës së pagave të datës 30.04.2021, leximi i licencës së punës me nr.prot.100007936 të datës 26.12.2012, leximi i kërkesës me nr.prot.4630 të datës 30.09.2021,

- Për paditësen D. M., bëhet leximi i kontratës së punës me nr.prot.118/18 të datës 01.11.2016, leximi i vërtetimit të punës me nr.prot.232 të datës 19.07.2021, leximi i diplomës së fakultetit me nr.1030 të datës 12.07.2014, leximi i listës së pagave të datës 30.04.2021, leximi i licencës së punës me nr.prot.1028903 të datës 16.03.2021, leximi i kërkesës me nr.prot.4630 të datës 30.09.2021,

- Për paditësen H. R. R., bëhet leximi i kontratës së punës të datës 11.10.2018, leximi i vërtetimit të punës me nr.prot.230 të datës 19.07.2021, leximi i diplomës së fakultetit me nr.2350 të datës 15.09.2015, leximi i listës së pagave të datës 30.04.2021, leximi i licencës së punës me nr.prot.100024518 të datës 11.04.2017, leximi i kërkesës me nr.prot.4630 të datës 30.09.2021.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat e nenit 7 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

**-Për paditësen H. G.-K.,** gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës, me nr.protokolli 59/18, të datës 01.09.2015, dhe nga kjo kontratë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja H. G.-K., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në institucionin arsimor SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit”, në fshatin Zatriq, komuna e Rahovecit.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar vërtetimin mbi përvojën e punës, me nr.protokolli 227, të datës 19.07.2021, të lëshuar nga drejtoria e shkollës “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq dhe nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja H. G. – K., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe, prej datës 01.09.2003.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar diplomën e fakultetit të Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nr.428 të datës 11.10.1997 dhe se nga kjo diplomë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja H. G.-K., ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filologjik dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar listën e pagave, të datës 30.04.2021, për paditësen H. G.-K. dhe se nga kjo listë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja H. G.-K., ka pranuar pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar licencën për paditësen H. G.-K. nr. prot. 08/2012/7687 të datës 22.03.2011 dhe nga kjo Licencë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja, H. G.-K., ka qenë e licencuar me - Licencë të karrierës nga data 26.12.2012, deri me datën 26.12.2017.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar e kërkesën me nr.prot.4639 të datës 03.09.2021, drejtuar DKA-së, në Rahovec dhe se nga kjo kërkesë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja H. G.-K., ka paraqitur kërkesë për kompensimin nga marrëdhënia e punës lidhur me licencimin.

**-Për paditësen A. S.,** gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës, me nr 106, të datës 01.09.2016, dhe nga kjo kontratë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja A. S., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Mësimdhënëse e Mësimi Klaser – Programi Fillor, në institucionin arsimor SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit”, në fshatin Zatriq, komuna e Rahovecit.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar vërtetimin mbi përvojën e punës, me nr.protokolli 228, të datës 19.07.2021, të lëshuar nga drejtoria e shkollës “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq dhe nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja A. S., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Mësimdhënëse e Mësimi Klaser – Programi Fillor, prej datës 01.09.2015.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar diplomën e fakultetit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, nr.74 të datës 15.01.2016 dhe se nga kjo diplomë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja A. S., ka përfunduar studimet në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, dega Programi Fillor.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar listën e pagave, të datës 30.04.2021, për paditësen A. S. dhe se nga kjo listë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja A. S., ka pranuar pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar licencën për paditësen A. S. nr. prot. 1027409 të datës 27.09.2019 dhe nga kjo Licencë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja, A. S., ka qenë e licencuar me - Licencë të Karrierës nga data 27.09.2019, deri me datën 27.09.2024.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar e kërkesën me nr.prot.4639 të datës 03.09.2021, drejtuar DKA-së, në Rahovec dhe se nga kjo kërkesë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja A. S., ka paraqitur kërkesë për kompensimin nga marrëdhënia e punës lidhur me licencimin.

**-Për paditësen M. D. - Xh.,** gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës, me nr.protokolli 107, të datës 10.05.2016, dhe nga kjo kontratë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja M. D. - Xh., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse – Bachelor i Kimisë - Fizikës, në institucionin arsimor SHFMU "Dëshmorët e Zatriqit", në fshatin Zatriq, komuna e Rahovecit.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar vërtetimin mbi përvojën e punës, me nr.protokolli 226, të datës 19.07.2021, të lëshuar nga drejtorja e shkollës "Dëshmorët e Zatriqit" në fshatin Zatriq dhe nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja M. D. - Xh., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e lëndës së Fizikës, prej datës 01.09.2011.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar diplomën e fakultetit të Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" nr.555 të datës 23.08.2019 dhe se nga kjo diplomë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja M. D. - Xh., ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit – drejtimi Fizik - Kimi.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar listën e pagave, të datës 30.04.2021, për paditësen M. D. - Xh. dhe se nga kjo listë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja M. D. - Xh., ka pranuar pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar licencën për paditësen M. D. - Xh. nr. prot. 100007936 të datës 26.12.2012 dhe nga kjo Licencë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja, M. D.- Xh., ka qenë e licencuar me - Licencë të karrierës nga data 26.12.2012, deri me datën 26.12.2017.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar e kërkesën me nr.prot.4639 të datës 03.09.2021, drejtuar DKA-së, në Rahovec dhe se nga kjo kërkesë, gjykata

pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja M. D. - Xh., ka paraqitur kërkesë për kompensimin nga marrëdhënia e punës lidhur me licencimin.

**-Për paditësen D. M.-H.,** gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës, me nr.protokolli 111/18, të datës 01.11.2016 dhe nga kjo kontratë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja D. M.-H., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e Gjuhës Angleze, në institucionin arsimor SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit”, në fshatin Zatriq, komuna e Rahovecit.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar vërtetimin mbi përvojën e punës, me nr.protokolli 232, të datës 19.07.2021, të lëshuar nga drejtoria e shkollës “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq dhe nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja D. M.-H., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e Gjuhës Angleze, prej datës 01.11.2016.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar diplomën e fakultetit të Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nr.1030 të datës 11.07.2014 dhe se nga kjo diplomë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja D. M.-H., ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit qendra në Prizren, drejtimi i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar listën e pagave, të datës 30.04.2021, për paditësen D. M.-Haxhimustafa dhe se nga kjo listë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja D. M.-H., ka pranuar pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar licencën për paditësen D. M.-Haxhimustafa nr. prot. 1028903 të datës 16.03.2021 dhe nga kjo Licencë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja, D. M.-H., ka qenë e licencuar me - Licencë të karrierës nga data 16.03.2021, deri me datën 16.03.2026.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar e kërkesën me nr.prot.4639 të datës 03.09.2021, drejtuar DKA-së, në Rahovec dhe se nga kjo kërkesë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja D. M.-H., ka paraqitur kërkesë për kompensimin nga marrëdhënia e punës lidhur me licencimin.

**-Për paditësen H. R. - R.,** gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës, 11.10.2018, dhe nga kjo kontratë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja H. R. - R., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e Matematikës-Informatikës, në institucionin arsimor SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit”, në fshatin Zatriq, komuna e Rahovecit.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar vërtetimin mbi përvojën e punës, me nr.protokolli 230, të datës 19.07.2021, të lëshuar nga drejtoria e shkollës “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq dhe nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja H. R. - R., ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, mësimdhënëse e lëndës së Matematikës-Informatikës, prej datës 01.09.2016.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar diplomën e fakultetit të Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nr.2350 të datës 15.07.2015 dhe se nga kjo diplomë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja H. R. - R., ka



përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit dega Matematikë-Informatikë.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar listën e pagave, të datës 30.04.2021, për paditësen H. R. - R. dhe se nga kjo listë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant, se këtu paditësja H. R.- R., ka pranuar pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar licencën për paditësen H. R. - R. nr. prot. 100024528 të datës 11.04.2017 dhe nga kjo Licencë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se paditësja, H. R. - R., ka qenë e licencuar me - Licencë të karrierës nga data 11.04.2017, deri me datën 11.04.202226.12.2017.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar e kërkesën me nr.prot.4639 të datës 03.09.2021, drejtuar DKA-së, në Rahovec dhe se nga kjo kërkesë, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja H. R. - R., ka paraqitur kërkesë për kompensimin nga marrëdhënia e punës lidhur me licencimin.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: "Mësimdhënësve me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar, u përcakton kompensimin në vlerën e 27% të pagës bazë, si dhe në paragrafin 1.4 të po të njëjtit nen, është paraparë se: "Mësimdhënësve me diplomë 5 vjeçar, magjistratur/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet në tërësi. Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t'ua bëjë kompensimin nga marrëdhënia e punës – licencim.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t'ia kompensoj paditësve shumën prej **645.00 Euro** e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 624.00 € dhe për taksë gjyqësore 21 Euro.

**GJYKATA THEMELROE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC,  
C.nr.1000/2021, më 19.12.2022**

**B. Profesional  
Afrim Gashi**

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.